

## LEJA “JOKER” – CONGÉ JOKER

Me fillimin e vitit shkollor në gusht 2024, familjet mund të përdorin lejen shkollore “joker” (xhoker). Për këtë lloj të ri lejeje, prindërit nuk kanë nevojë të japin ndonjë justifikim. Leja “joker” miratohet automatikisht, për sa kohë respektohen kushtet që vijnë:

- Mund të njoftohen e shumta 6 gjysmëditë leje “joker” në një vit shkollor;
- Mund të merren e shumta 2 gjysmëditë leje “joker” njëherësh, edhe nëse ato ndahen nga një fundjavë, pushime, një ditë feste apo një leje kolektive;
- Leja “joker” i njoftohet me shkrim drejtpërdrejt mësueses ose mësuesit kujdestar/e klase;
- Ajo duhet të njoftohet të paktën 2 ditë para;
- Lejet “joker” nuk janë të mundshme:
  - ditën e parë të shkollës;
  - gjatë daljeve pedagogjike, ekskursioneve shkollore, kampeve, etj.;
  - në ditët e provimeve kantonale të referencës, në ditët e provimit të certifikatës;
- Nuk është e mundur të merret një leje “joker” nëse nxënësi e ka marë tashmë barasvlerën e 2 javëve leje (me arsye + “joker”) gjatë vitit shkollor;
- Anulimi i një lejeje “joker” duhet të bëhet të paktën 2 ditë para. Përndryshe, leja “joker” do të quhet e përdorur.

Si për çdo lloj tjetër mungese, prindërit duhet të sigurohen që fëmija i tyre të kapë punën e pabërë. Secili mësues a mësuese u jep atyre elementet e nevojshme për ta bërë këtë.

Justifikimet për mungesën me leje në këtë agjenda (faqja 99 dhe ato vijuese) nuk e kanë simbolin e katrorit “congé joker” (leje “joker”). Ndërkohë, mund të shkruhet “congé joker” në pjesën *Motif* (arsyeja). Një version numerik i përditësuar gjendet në linjë (lidhja majtas këtu sipër).



## Shembuj të përdorimit të lejes “joker”

### Për të zgjatur një fundjavë

- ✓ një të premte tërë ditën
- ✓ një të hënë tërë ditën
- ✓ një të premte pasdite dhe të hënë paradite vijuese
- ✗ një të enjte dhe një të premte tërë ditën (= 4 gjysmëditë njëherësh)
- ✗ një të premte dhe të hënë vijuese tërë ditën (= 4 gjysmëditë njëherësh)

### Për të përfituar nga një leje gjatë javës

- ✓ një të martë ose një të enjte tërë ditën
- ✓ një të mërkurë paradite
- ✓ një të martë pasdite dhe të mërkurën paradite
- ✓ ditën që paraprin një ditë lejeje të jashtëzakonshme për tërë nxënësit e institucionit
- ✗ një të martë tërë ditën dhe të mërkurën paradite (= 3 gjysmëditë njëherësh)
- ✗ një të mërkurë paradite dhe të enjten tërë ditën (= 3 gjysmëditë njëherësh)

### Për të shkuar një ditë më përpara me pushime ose në një fundjavë të zgjatur, ose për tu kthyer një ditë më vonë

- ✓ ditën e premte që paraprin pushimet
- ✓ ditën e hënë që vjen pas pushimeve (me përjashtim të fillimit të vitit shkollor në gusht)
- ✓ ditën e martë që vjen pas fundjavës së Agjërimit (*Le Jeûne*, ditë feste lokale)
- ✓ të premten pasdite që paraprin pushimet dhe të hënë paradite që vjen pas tyre
- ✗ ditën e premte që paraprin pushimet dhe ditën e hënë që vjen pas tyre (= 4 gjysmëditë njëherësh)
- ✗ a manhã de quarta-feira que antecede o fim-de-semana da Ascensão e a segunda-feira seguinte (= 3 gjysmëditë njëherësh)

### Për të zgjatur një leje individuale me arsye të dhënë

- ✗ ditën e shkollës që paraprin ditën e parë të lejes individuale me arsye të dhënë (= paraprin menjëherë lejen individuale me arsye të dhënë)
- ✗ të hënë që vjen pas një lejeje individuale me arsye të dhënë që mbaron të premten paraprirëse (= vjen menjëherë pas lejes së dhënë)